



BASHKIA
LEZHË



BASHKIA
MIRDITË

DEKLARATA E PËRBASHKËT Parlamenti **IV** Rural Shqiptar 2026



Shqipëria rurale në rrugën drejt BE-së përmes partneriteteve, reformës dhe zhvillimit territorial koheziv

BASHKITË PRITËSE:

Bashkia e Lezhës dhe Bashkia e Mirditës

25-27 MARS 2026



Ministero degli Affari Esteri
e della Cooperazione Internazionale



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



Funded by
the European Union



FARM Le FORK
ACADEMY



Hyrje

Ne, 300 pjesëmarrësit e Parlamentit IV Rural Shqiptar, të mbledhur më 25-27 mars 2026 në bashkitë pritëse Mirditë dhe Lezhë, përfaqësues të komuniteteve rurale, fermerëve, organizatave të shoqërisë civile, grupeve vendore të veprimit (GVV), institucioneve publike, autoriteteve vendore, akademisë, biznesit dhe partnerëve të zhvillimit, riafirmojmë angazhimin tonë të përbashkët për një Shqipëri rurale më të fortë, më të qëndrueshme dhe më të përfshirë në rrugën drejt Bashkimit Evropian (BE).

Parlamenti IV Rural Shqiptar u zhvillua në një moment përcaktues për vendin. Ndërsa Shqipëria avancon në procesin e anëtarësimit në BE, zhvillimi bujqësor dhe rural nuk mund të trajtohen si çështje sektoriale apo periferike, por si komponentë strategjike të transformimit ekonomik, social dhe territorial të Shqipërisë. Zonat rurale janë një pjesë e rëndësishme e prodhimit ushqimor, trashëgimisë kulturore, burimeve natyrore dhe kohezionit social të vendit, por vijnë të përballen me fragmentim ekonomik, shpopullim, pabarazi territoriale, kapacitete të kufizuara dhe akses të pamjaftueshëm në shërbime, tregje dhe vendimmarrje. Prandaj, rruga e Shqipërisë drejt BE-së duhet të përkthehet në reforma konkrete që forcojnë komunitetet rurale, rrisin konkurrueshmërinë, mbrojnë burimet natyrore dhe krijojnë mundësi të barabarta për fermerët, gratë, të rinjtë dhe aktorët lokalë.

Kjo Deklaratë bazohet në diskutimet që u shtruan gjatë tri ditëve të Parlamentit të IV Kombëtar Rural, përfundimet dhe rekomandimet e shtatë "Diskutimeve Tematike", të cilat sollën së bashku qindra aktorë lokalë dhe kombëtarë për të adresuar sfidat dhe mundësitë kryesore të zhvillimit rural. Dialogu u fokusua në zhvillimin rural gjithëpërfshirës dhe qasjen LEADER, bujqësinë e qëndrueshme dhe tranzicionin e gjelbër, fuqizimin e grave rurale, dijen, inovacionin dhe digjitalizimin, ekonominë rurale të qëndrueshme dhe zinxhirët e shkurtër të vlerës, bujqësinë familjare dhe trashëgiminë e transhumancës si aset strategjik për të ardhmen e zonave rurale.

Përmes kësaj Deklarate, ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Kuvendit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZhR) dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për bujqësinë, ushqimin, zhvillimin rural dhe integrimin evropian, njësisive të vetëqeverisjes vendore, sektorit privat, akademisë dhe partnerëve të zhvillimit që të ndërmarrin veprime konkrete për të siguruar që transformimi rural të bëhet një prioritet kombëtar. Investimi në zonat rurale nuk mund të jetë vetëm një politikë sektoriale, por një kusht për kohezionin territorial, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për suksesin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë.

Prandaj, mesazhet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë Deklaratë përfaqësojnë zërin e përbashkët të komuniteteve rurale dhe një kontribut konkret për ndërtimin e politikave publike që i japin mundësi Shqipërisë rurale të zhvillohet, të konkurrojë dhe të prosperojë në familjen evropiane.

ÇËSHTJET TEMATIKE TË AGJENDËS SË PARLAMENTIT TË IV KOMBËTAR RURAL

Zhvillimi gjithëpërfshirës dhe i integruar rural, përfaqëson një prioritet për Shqipërinë në këtë fazë të zhvillimit të saj, duke reflektuar nevojën për të adresuar sfida të ndërlydhura si pabarazitë territoriale, migrimi i vazhdueshëm nga zonat rurale, fragmentimi i zhvillimit ekonomik dhe pjesëmarrja e kufizuar e komuniteteve lokale në vendimmarrje. Në të njëjtën kohë, procesi i integritimit në BE dhe përafrimi me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB), si dhe zbatimi i Programit IPARD III, krijojnë një mundësi konkrete për të avancuar modele të reja zhvillimi të bazuara në qasje të integruara, gjithëpërfshirëse dhe të udhëhequra nga komuniteti. Qasja LEADER / Zhvillimi Lokal i Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD) ofrojnë një instrument të provuar për fuqizimin e aktorëve vendorë, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publik, privat dhe shoqërisë civile, si dhe për ndërtimin e strategjive territoriale që adresojnë nevojat reale të komuniteteve. Megjithatë, sfida të rëndësishme mbeten ende, përfshirë kapacitetet e kufizuara lokale, koordinimin e dobët institucional, përfshirjen e pamjaftueshme të të rinjve, grave dhe grupeve vulnerabël, si dhe mungesën e mekanizmave funksionale për bashkëpunim territorial. Në këtë kontekst, zhvillimi gjithëpërfshirës rural paraqet një mundësi të rëndësishme për të nxitur zhvillimin ekonomik, për të forcuar kohezionin social dhe për të përshpejtuar procesin e integritimit evropian të vendit.

Në këtë fazë zhvillimi, dhe në kontekstin e procesit të integritimit në BE, **bujqësia e qëndrueshme dhe tranzicioni i gjelbër** përfaqësojnë një prioritet strategjik për Shqipërinë. Përtej dimensionit mjedisor, ky tranzicion lidhet drejtpërdrejt me konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor, sigurinë ushqimore, qëndrueshmërinë ekonomike të fermerëve dhe kohezionin social në zonat rurale. Ndërkohë që politikat evropiane, si Marrëveshja e Gjelbër, Strategjia “Nga ferma në tryezë” dhe Politika e Përbashkët Bujqësore, përcaktojnë një drejtim të qartë drejt sistemeve ushqimore më të qëndrueshme, Shqipëria përballlet me sfida të thella strukturore që e bëjnë këtë tranzicion kompleks, sikurse janë fragmentimi i fermave, integritimi i dobët në zinxhirët e vlerës, informaliteti, mungesa e investimeve dhe kapacitetet e kufizuara për përmbushjen e standardeve. Në të njëjtën kohë, ekziston një potencial i konsiderueshëm për zhvillimin e sektorëve me vlerë të shtuar, për forcimin e lidhjeve me tregun dhe për adoptimin e praktikave më të qëndrueshme, siç tregojnë edhe iniciativat në terren që lidhin prodhimin me inovacionin dhe tregun. Kjo bën të qartë se tranzicioni i gjelbër në Shqipëri nuk është thjesht një detyrim në kuadër të përafrimit me BE-në, por një mundësi reale për të transformuar sektorin bujqësor drejt një modeli që është njëkohësisht më produktiv, më konkurrues dhe më i qëndrueshëm. Duhet theksuar se ky transformim kërkon politika të koordinuara që vendosin fermerin në qendër, forcojnë zinxhirët e vlerës dhe lidhin objektivat mjedisore me zhvillimin ekonomik dhe social të zonave rurale. Kjo nënkupton gjithashtu mbështetje për organizimin e fermerëve, marrëdhënie kontraktuale më të drejta dhe investime kolektive në magazinim, ftohje dhe përpunim, si kushte të domosdoshme për një tranzicion të gjelbër që është i zbatueshëm, i përballueshëm dhe i drejtë për fermerët.

Fuqizimi i grave në zonat rurale është një prioritet strategjik për zhvillimin rural të Shqipërisë dhe për procesin e integritimit në BE. Gratë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të fuqisë punëtore në bujqësi dhe kontribuojnë çdo ditë në prodhim, përpunim, ekonominë familjare dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve rurale. Megjithatë, ky kontribut mbetet shpesh i padukshëm dhe i pambështetur, ndërsa gratë përballen me pengesa strukturore në aksesin në tokë, financë, tregje, shërbime dhe vendimmarrje. Niveli i ulët i pronësisë mbi tokën, pjesëmarrja e kufizuar në skemat mbështetëse dhe angazhimi i lartë në punë të papaguar familjare tregojnë se gratë rurale nuk janë ende të pozicionuara si aktore të barabarta ekonomike. Kjo nuk është vetëm çështje e barazisë gjinore, por një sfida e

drejtpërdrejtë për konkurrueshmërinë e bujqësisë, zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe kohezionin social. Në kuadër të përafrimit me politikën e BE-së, veçanërisht me PPB, LEADER/ CLLD, Strategjinë e Barazisë Gjinore dhe Vizionin Afatgjatë për Zonat Rurale, Shqipëria ka mundësinë dhe detyrimin të ndërtojë politika më gjithëpërfshirëse, që e zhvendosin gruan rurale nga pozicioni i “përfitueseve” drejt rolit të vendimmarrëseve, sipërmarrëseve dhe bashkëformuesve të zhvillimit lokal. Fuqizimi i grave rurale është, për rrjedhojë, një kusht për një të ardhme rurale më të drejtë, më produktive dhe më të qëndrueshme.

Njohuritë, inovacioni dhe digjitalizimi po kthehen në kushte strategjike për të ardhmen e zhvillimit rural në Shqipëri. Në një sektor që vijon të karakterizohet nga ferma shumë të vogla dhe të fragmentuara, akses i kufizuar në këshillim të besueshëm, informacion të pamjaftueshëm mbi tregjet dhe shërbime institucionale jo gjithmonë të arritshme për fermerët, shërbimet publike digjitale mund të luajnë një rol transformues në ngushtimin e boshllëqeve të informacionit, forcimin e besimit tek udhëzimet zyrtare dhe lidhjen më të mirë mes fermerëve, tregjeve dhe institucioneve publike. Instrumente si “Portali i fermerit” duhen perceptuar si pjesë e një agjende më të gjerë reformuese për modernizimin e shërbimeve bujqësore, forcimin e kapaciteteve administrative dhe përgatitjen e Shqipërisë për sisteme të përafruara me BE-në në bujqësi dhe zhvillim rural. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e integritimit evropian, ku Shqipërisë i kërkohet të forcojë sistemet digjitale dhe statistikore, ndërveprueshmërinë dhe ripërdorimin e të dhënave, thjeshtimin e procedurave administrative dhe përafrimin me acquis të BE-së, përfshirë kërkesat që lidhen me IPARD III dhe sistemet e ardhshme të lidhura me PPB-në. Megjithatë, digjitalizimi do të ketë vlerë vetëm nëse i përgjigjet nevojave reale të fermerëve: informacion i besueshëm mbi skemat mbështetëse, tregjet, pikat e grumbullimit, motin, kalendarët bujqësorë, këshillimin fitosanitar dhe menaxhimin praktik të fermës. Sfidë kryesore nuk është vetëm ndërtimi i një platforme digjitale, por siguri i përdorimit, besimit, përfshirjes dhe qëndrueshmërisë institucionale të saj, veçanërisht për fermerët e vegjël, gratë, të rinjtë, komunitetet e largëta dhe përdoruesit me aftësi më të kufizuara digjitale. Nëse ndërtohet mbi realitetin e fermerëve dhe mbështetet nga institucione publike funksionale, shërbime këshillimore dhe ndërmjetës lokale, “Portali i fermerit” mund të kthehet në një instrument strategjik për një zhvillim rural më transparent, më gjithëpërfshirës dhe më të orientuar drejt BE-së.

Ekonomia rurale e qëndrueshme dhe zinxhirët e shkurtër të vlerës përfaqësojnë një drejtim strategjik për zhvillimin rural të Shqipërisë, veçanërisht në një kontekst ku fermerët e vegjël përballen me fragmentim të prodhimit, fuqi të kufizuar negociuese, akses të dobët në tregje dhe vështirësi për të kapur vlerën reale të produkteve të tyre. Forcimi i zinxhirëve të shkurtër nuk është thjesht një çështje tregtimi lokal, por një instrument për të rritur të ardhurat e fermerëve, për të mbështetur ekonominë vendore, për të promovuar produkte cilësore dhe për të ndërtuar lidhje më të drejtpërdrejta mes prodhuesve, konsumatorëve, turizmit dhe territorit. Në kuadër të integritimit evropian, kjo temë lidhet drejtpërdrejt me prioritetet e PPB-së, e cila mbështet fermerët, prodhimin e qëndrueshëm ushqimor, zhvillimin rural, mbrojtjen e mjedisit dhe investimet në zonat rurale. Për Shqipërinë, mundësia qëndron në ndërtimin e modeleve funksionale të bashkëpunimit, përpunimit lokal, tregtimit të drejtpërdrejtë, agroturizmit dhe markave territoriale. Megjithatë, kjo kërkon politika dhe investime që forcojnë organizimin e fermerëve, standardet e cilësisë, infrastrukturën, logjistikën dhe aksesin në financë. Vetëm duke e lidhur prodhimin lokal me tregun, territorin dhe konsumatorin, ekonomia rurale mund të bëhet më konkurruese, më gjithëpërfshirëse dhe më e qëndrueshme.

Bujqësia familjare mbetet një shtyllë e rëndësishme e jetesës rurale, siguri e ushqimore dhe qëndrueshmërisë territoriale në Shqipëri, veçanërisht në një kontekst ku fermat e vogla përbëjnë pjesën më të madhe të strukturës bujqësore dhe ku familjet rurale vazhdojnë të mbajnë gjallë prodhimin, traditat, peizazhin dhe ekonominë lokale. Megjithatë, potenciali i

bujqësisë familjare kufizohet nga fragmentimi i tokës, plakja dhe largimi i popullsisë rurale, aksesit në financë, teknologji, tregje dhe shërbime këshillimore, si dhe nga njohja e pamjaftueshme e rolit të grave dhe të rinjve në fermat familjare. Në kuadër të Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë Familjare 2019-2028, Shqipëria ka mundësinë për ta trajtuar bujqësinë familjare jo si një sektor tradicional që duhet mbështetur vetëm për mbijetesë, por si një aktor strategjik për zhvillim rural të qëndrueshëm, sisteme ushqimore më të sigurta, ruajtje të burimeve natyrore dhe përfshirje sociale. Kjo lidhet drejtpërdrejt edhe me procesin e integritimit në BE, ku përafrimi me politikat e zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, qëndrueshmërisë mjedisore dhe forcimit të zinxhirëve të vlerës kërkon politika më të përshtatshme për fermat e vogla dhe familjare. Prandaj, hartimi dhe zbatimi i një Plani Kombëtar Veprimi për Bujqësinë Familjare duhet të shërbejë si një instrument strategjik politik për të forcuar pozitën ekonomike të familjeve fermere, për të rritur aksesin e tyre në mbështetjen publike dhe tregje, dhe për ta vendosur bujqësinë familjare në qendër të një modeli të zhvillimit rural më të drejtë, më konkurrues dhe më të qëndrueshëm.

Trashëgimia e transhumancës përfaqëson një pasuri strategjike për zhvillimin rural të Shqipërisë, duke lidhur traditën baritore, menaxhimin e qëndrueshëm të peizazheve malore, identitetin kulturor dhe ekonominë lokale. Në një kohë kur zonat rurale përballen me shpopullim, humbje të praktikave tradicionale, presion mbi burimet natyrore dhe dobësim të ekonomive malore, transhumanca duhet parë jo vetëm si trashëgimi kulturor jomateriale, por si një model i gjallë zhvillimi që mund të kontribuojë në zhvillimin e një blegtorie të qëndrueshme, turizmin rural, produkte lokale cilësore dhe ruajtje të biodiversitetit. Në kontekstin e integritimit në BE, kjo temë lidhet drejtpërdrejt me politikat për zhvillimin rural, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe valorizimin e ekonomive territoriale. Sfida kryesore qëndron në faktin se këto praktika rrezikojnë të mbeten të pambështetura nga politikat publike, të shkëputura nga tregjet dhe të padukshme në strategjitë e zhvillimit. Prandaj, njohja, mbrojtja dhe valorizimi i transhumancës duhet të kthehen në një prioritet politik për të lidhur trashëgiminë me zhvillimin ekonomik, për të forcuar komunitetet baritore dhe për të ndërtuar ura mes traditës shqiptare dhe perspektivës evropiane të zhvillimit rural.

Për sa më sipër, pjesëmarrësit e Parlamentit Rural Shqiptar nënvizojnë se këto prioritetet kërkojnë jo vetëm angazhim politik, por edhe masa konkrete, të zbatueshme dhe të prekshme. Rekomandimet në vijim synojnë të orientojnë veprimin institucional dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve për ta kthyer zhvillimin rural në një proces më gjithëpërfshirës, më të drejtë dhe më të lidhur me perspektivën evropiane të Shqipërisë.

Ne besojmë se pa një politikë të re për zhvillimin rural, Shqipëria rrezikon të humbasë kapitalin e saj më të rëndësishëm territorial, njerëzor dhe natyror. Prandaj, bëjmë thirrje që zhvillimi rural të trajtohet si prioritet kombëtar dhe pjesë integrale e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke vendosur komunitetet rurale në qendër të reformave, investimeve dhe vendimmarrjes publike.

MESAZHET KRYESORE DHE REKOMANDIMET

Deklarata e Parlamentit IV Rural Shqiptar përcjell disa mesazhe kyçe dhe rekomandime strategjike, të cilat duhet të udhëheqin reformat, investimet dhe dialogun për zhvillimin rural për periudhën 2026 - 2030.

1. Zhvillimi rural nuk mund të ndërtohet pa pjesëmarrjen e komuniteteve lokale. LEADER/CLLD duhet të institucionalizohet si instrument kombëtar për zhvillimin territorial, demokracinë vendore dhe integrimin evropian të Shqipërisë.

Zhvillimi gjithëpërfshirës rural nuk mund të arrihet vetëm përmes projekteve të veçuara apo ndërhyrjeve nga lart-poshtë. Shqipëria ka nevojë ta kthejë qasjen LEADER/CLLD në një instrument real politikash publike, që fuqizon komunitetet rurale, ndërton partneritete vendore dhe lidh zhvillimin lokal me procesin e integritimit në BE. Për politikëbërësit, mesazhi është i qartë: pa animim territorial, kapacitete lokale, GVV funksionale dhe strategji zhvillimi të hartuara me pjesëmarrjen e komunitetit, LEADER rrezikon të mbetet një koncept formal. Nëse zbatohet siç duhet, ai mund të bëhet një nga mjetet më të rëndësishme për demokraci vendore, diversifikim ekonomik, përfshirje sociale dhe zhvillim të qëndrueshëm të territoreve rurale.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar zbatimin real të qasjes LEADER/CLLD në Shqipëri, është e nevojshme që MBZhr, në bashkëpunim me bashkitë, shoqërinë civile dhe partnerët zhvillimorë, të institucionalizojë qasjen LEADER si instrument të politikave publike, përmes një kuadri të qartë ligjor, institucional dhe financiar.
- Për të mundësuar krijimin e partneriteteve funksionale territoriale, është e nevojshme që institucionet publike dhe aktorët vendorë të mbështesin ngritjen dhe funksionimin e GVV-ve përmes animimit territorial, ngritjes së kapaciteteve dhe përfshirjes reale të fermerëve, grave, të rinjve, biznesit dhe shoqërisë civile.
- Për të mundësuar zhvillim rural të bazuar në nevojat dhe potencialet reale të territorit, është e nevojshme që bashkitë, GVV-të dhe komunitetet lokale të hartojnë Strategji Lokale Zhvillimi me pjesëmarrje të gjerë, përmes proceseve transparente, nga poshtë-lart dhe të orientuara drejt diversifikimit ekonomik, inovacionit dhe përfshirjes sociale.
- Për të mundësuar që qasja LEADER të kontribuojë në integrimin evropian dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural, është e nevojshme që Qeveria shqiptare dhe partnerët zhvillimorë të sigurojnë mekanizma të qëndrueshëm financimi, asistencë teknike dhe monitorimi për zbatimin efektiv të masës LEADER në kuadër të Programit IPARD III dhe instrumenteve të ardhshme të PPB-së.

2. Tranzicioni i gjelbër do të ketë sukses vetëm nëse fermerët vendosen në qendër të politikave publike, duke u mbështetur me njohuri, financim, teknologji dhe akses të drejtë në tregje.

Tranzicioni i gjelbër në bujqësi nuk mund të kërkohet nga fermerët pa u dhënë atyre njohuri, inpute cilësore, financim të përshtatshëm, kontroll institucional dhe akses në tregje. Nëse

Shqipëria synon një bujqësi më të qëndrueshme dhe të përafruar me standardet e BE-së, politikat publike duhet të kalojnë nga mbështetja e përgjithshme drejt ndërhyrjeve konkrete që ulin kostot, rrisin cilësinë, forcojnë gjurmueshmërinë dhe ndihmojnë fermerët të prodhojnë në mënyrë më të sigurt, më konkurruese dhe më miqësore me mjedisin. Në këtë proces, mbështetja për grupet e prodhuesve, kontratat e drejta me blerësit dhe investimet kolektive në infrastrukturë pas-vjeljes janë thelbësore për të rritur cilësinë, fuqinë negociuese dhe pjesën e vlerës që përfitojnë fermerët.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar prodhim bujqësor më të qëndrueshëm dhe të bazuar në njohuri, është e nevojshme që MBZHR, institucionet kërkimore dhe shërbimet këshillimore të forcojnë mbështetjen teknike për fermerët, përmes udhëzimeve praktike mbi analizat e tokës, përzgjedhjen e farërave, fidanëve dhe përdorimin e inputeve.
- Për të mundësuar një tranzicion të gjelbër të besueshëm dhe të sigurt, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse të rrisin kontrollin dhe monitorimin e inputeve bujqësore, përmes sistemeve funksionale të inspektimit, standardizimit dhe gjurmueshmërisë.
- Për të mundësuar që fermerët të përballojnë kostot e tranzicionit drejt praktikave më të qëndrueshme, është e nevojshme që qeveria dhe institucionet financiare të zhvillojnë skema mbështetëse më efektive, përmes subvencioneve të përshtatura, financimit të përshtatur dhe mbështetjes për mekanizim e teknologji.
- Për të mundësuar bujqësi më konkurruese dhe të përafruar me standardet e BE-së, është e nevojshme që institucionet publike, bashkitë dhe aktorët e zinxhirit të vlerës të zhvillojnë orientim rajonal të prodhimit, përmes studimeve territoriale, certifikimit të produkteve dhe lidhjes më të mirë të fermerëve me tregjet.

3. Nuk mund të ketë zhvillim rural të qëndrueshëm pa fuqizimin ekonomik, social dhe politik të grave të angazhuara në bujqësi dhe zhvillim rural. Gratë duhet të trajtohen si aktore të barabarta të zhvillimit dhe jo vetëm si përfituese të politikave publike.

Fuqizimi i grave rurale nuk mund të trajtohet vetëm si çështje sociale apo e barazisë gjinore, por si parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm, sigurinë ekonomike dhe integrimin evropian. Zbatimi efektiv i të drejtave ekzistuese të grave, përfshirë të drejtat pronësore, aksesin në financë, shërbime, aftësi dhe vendimmarrje, është thelbësor për të shndërruar potencialin e tyre në motor të zhvillimit ekonomik dhe social të komuniteteve rurale. Politikat publike duhet të mbështeten jo vetëm në programe të reja, por edhe në zbatimin e plotë të kuadrit ligjor për barazinë gjinore, të drejtat pronësore, përfshirjen ekonomike dhe mbrojtjen sociale të grave në zonat rurale.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar fuqizimin ekonomik të grave rurale, qeveria, institucionet financiare dhe programet mbështetëse duhet të rrisin aksesin e grave në financë, përmes granteve të dedikuara, kredive të përshtatura dhe skemave mbështetëse për fermat dhe bizneset e drejtuara nga gra.
- Për të mundësuar barazi reale ekonomike në zonat rurale, institucionet përgjegjëse duhet të garantojnë njohjen e pronësisë së grave mbi tokën bujqësore, përmes

regjistrimit të përbashkët të pronës, këshillimit ligjor dhe lidhjes së skemave mbështetëse me dokumentimin e të drejtave pronësore.

- Për të mundësuar pjesëmarrjen e grave në punësim, sipërmarrje dhe zhvillim lokal, bashkitë dhe institucionet publike duhet të forcojnë shërbimet sociale dhe infrastrukturën rurale, përmes çerdheve, kopshteve, transportit, shërbimeve shëndetësore dhe mbështetjes për kujdesin familjar.
- Për të mundësuar kalimin e grave rurale nga puna e papaguar drejt rolit të aktoreve ekonomike dhe vendimmarrëse, institucionet arsimore, shërbimet këshillimore dhe programet e zhvillimit rural duhet të ofrojnë formim profesional, këshillim bujqësor, aftësi digjitale, mbështetje për sipërmarrje, dhe mundësi për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse lokale, përmes programeve të aksesueshme për gratë dhe vajzat në zonat rurale.

4. Digjitalizimi duhet të shërbejë për të afruar fermerët me shërbimet publike, tregjet dhe informacionin, duke e bërë administratën më të thjeshtë, më transparente dhe më të aksesueshme për të gjithë.

Digjitalizimi në bujqësi nuk duhet të trajtohet thjesht si krijim platformash apo aplikacionesh, por si reformë e qeverisjes rurale. “Portali i fermerit” mund të bëhet një instrument strategjik për transparencë, akses në shërbime, thjeshtim të procedurave administrative dhe përafrim me standardet e BE-së, vetëm nëse ndërtohet mbi realitetin e fermerëve. Pa infrastrukturë dhe aftësi digjitale, besim tek institucionet, mbështetje njerëzore dhe mirëmbajtje të qëndrueshme, digjitalizimi rrezikon të krijojë një hendek të ri mes fermerëve dhe shërbimeve publike.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar që “Portali i fermerit” të shërbejë si instrument real i qeverisjes rurale, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse të garantojnë akses në teknologji, infrastrukturë digjitale dhe mbështetje praktike për fermerët, përmes investimeve të planifikuara në zonat rurale dhe asistencës në terren.
- Për të mundësuar përdorim të gjerë dhe të besueshëm të shërbimeve digjitale, është e nevojshme që MBZHR, bashkitë dhe shërbimet këshillimore të rrisin aftësitë digjitale të fermerëve, përmes trajnimeve praktike, pikave të asistencës dhe ndërmjetësve lokalë.
- Për të mundësuar thjeshtim real të marrëdhënies së fermerëve me administratën, është e nevojshme që qeveria të integrojë në Portalin e Fermerit proceset kryesore bujqësore, përmes shërbimeve të qarta për aplikime për subvencione, regjistrimin e tokës, deklarimin e prodhimit dhe akses në informacionin zyrtar.
- Për të mundësuar që digjitalizimi të jetë i qëndrueshëm dhe i përafruar me standardet e BE-së, është e nevojshme që institucionet publike të sigurojnë mirëmbajtje, përditësim dhe koordinim ndër-institucional të sistemit, përmes roleve të qarta, përgjegjësi të përcaktuara dhe mekanizmave të monitorimit.

5. Fermerët duhet të përfitojnë një pjesë më të madhe të vlerës që krijojnë. Forcimi i zinxhirëve të shkurtër të vlerës është çelësi për ekonomi rurale më konkurruese, më të qëndrueshme dhe më të lidhura me territorin.

Ekonomia rurale e qëndrueshme nuk mund të ndërtohet nëse fermerët mbeten hallka më e dobët e tregut. Zinxhirët e shkurtër të vlerës duhet të trajtohen si instrument politik për të rritur të ardhurat e fermerëve, për të ulur varësinë nga ndërmjetësit, për të forcuar tregjet lokale dhe për të lidhur prodhimin bujqësor me territorin, konsumatorin dhe turizmin rural. Për këtë, politikat publike duhet të adresojnë njëkohësisht sfidat klimatike, ujitjen, inputet, pronësinë, kostot, subvencionet, këshillimin dhe përfaqësimin e fermerëve. Pa këto ndërhyrje, zhvillimi rural rrezikon të mbetet i fragmentuar dhe i padrejtë.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar që fermerët të fitojnë më shumë vlerë nga prodhimi i tyre, është e nevojshme që MBZhR, bashkitë dhe aktorët e tregut të mbështesin zinxhirët e shkurtër të vlerës, përmes tregjeve lokale, kontratave të drejta, pikave të grumbullimit, agroturizmit dhe lidhjeve direkte me konsumatorët.
- Për të mundësuar një ekonomi rurale më të qëndrueshme ndaj krizave klimatike dhe kostove të larta, është e nevojshme që qeveria dhe institucionet vendore të investojnë në ujitje, infrastrukturë mbrojtëse dhe mekanizma uljeje të kostove, përmes financimit specifik, politikave fiskale të drejta dhe skemave mbështetëse për fermerët e vegjël.
- Për të mundësuar produkte më cilësore, të sigurta dhe konkurruese, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse të forcojnë kontrollin e inputeve, monitorimin agronomik dhe këshillimin bujqësor, përmes inspektimit funksional, shërbimeve të ekstensionit bujqësor dhe orientimit teknik të fermerëve.
- Për të mundësuar zhvillim të drejtë dhe gjithëpërfshirës të zinxhirëve të vlerës, është e nevojshme që qeveria të adresojë fragmentimin e tokës, përfaqësimin e dobët dhe shpërndarjen e pabarabartë të fondeve, përmes reformave të pronësisë, organizimit të fermerëve dhe skemave transparente të subvencioneve.

6. Bujqësia familjare qëndron në themelin e sigurisë ushqimore, vitalitetit rural dhe kohezionit territorial. Politikat publike duhet ta ndihmojnë fermën familjare të kalojë nga mbijetesa drejt zhvillimit dhe konkurrueshmërisë.

Bujqësia familjare nuk duhet të shihet si mbetje e një modeli tradicional prodhimi, por si bazë strategjike për sigurinë ushqimore, ekonominë rurale, menaxhimin e territorit dhe vitalitetin social të fshatit shqiptar. Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale të Shqipërisë duhet të bazohet në fuqizimin e bujqësisë familjare si një shtyllë e rëndësishme e ekonomisë bujqësore, duke vlerësuar kontributin e saj në garantimin e ushqimit, ruajtjen e mjedisit, zhvillimin ekonomik lokal dhe gjallërimin social të zonave rurale. Nëse Shqipëria synon përafrim real me PPB të BE-së, politikat publike duhet ta ndihmojnë fermën familjare të kalojë nga mbijetesa drejt një modeli më produktiv, të formalizuar, të organizuar, të qëndrueshëm dhe të orientuar nga tregu. Në këtë proces, përgatitja e Shqipërisë për PPB duhet të marrë në konsideratë karakteristikat specifike të strukturës së saj bujqësore, veçanërisht dominimin e fermave të vogla familjare dhe copëzimin e tokës bujqësore, të cilat kërkojnë politika të përshtatura dhe mbështetje të posaçme. Kjo kërkon të dhëna të sakta, regjistrim të tokës, shërbime këshillimore funksionale, bashkëpunim mes fermerëve, masa për zbutjen e ndikimeve klimatike dhe masa konkrete për të rinjtë në bujqësi.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar politika më të drejta dhe specifike për bujqësinë familjare, është e nevojshme që MBZhR dhe institucionet përgjegjëse të krijojnë një bazë të unifikuar të

të dhënave për fermat, përmes regjistrimit të fermës, lidhjes me kadastrën, AZHBR-në, bashkitë dhe sistemin e identifikimit të parcelave.

- Për të mundësuar formalizimin dhe zgjerimin e qëndrueshëm të fermave familjare, është e nevojshme që qeveria të përfundojë regjistrimin e tokës dhe zbatimin e kuadrit ligjor për përdorimin e saj, përmes afateve të qarta për AMTP-të, akteve nënligjore për qiranë bujqësore dhe regjistrimit të administratorit të fermës familjare.
- Për të mundësuar kalimin e fermave familjare nga prodhim mbijetese drejt tregut, është e nevojshme që shërbimet këshillimore, bashkitë dhe programet mbështetëse të forcojnë njohuritë, bashkëpunimin dhe lidhjen me tregun, përmes AKIS, SHBB-ve, kontraktimit me agroturizmin, markave lokale dhe modeleve të grupimit.
- Për të mundësuar ripërtëritjen e brezave dhe qëndrueshmërinë klimatike të bujqësisë familjare, është e nevojshme që qeveria, bashkitë dhe institucionet financiare të krijojnë masa të posaçme për të rinjtë dhe mbrojtjen nga rreziqet klimatike, përmes skemave të start-up në bujqësi, lehtësive fiskale vendore, paketave teknologjike të qëndrueshme dhe mekanizmave të siguracionit në bujqësi.

7. Transhumanca është njëherazi traditë që duhet ruajtur, dhe aset strategjik për biodiversitetin, ekonominë malore, turizmin rural dhe identitetin evropian të Shqipërisë rurale.

Transhumanca kontribuon në ruajtjen e biodiversitetit, menaxhimin e qëndrueshëm të kullotave, prodhimin e produkteve me identitet territorial, zhvillimin e turizmit rural dhe mbajtjen gjallë të komuniteteve malore. Humbja e transhumancës do të thotë humbje e njohurive tradicionale, degradim i peizazheve rurale dhe dobësim i ekonomive lokale. Për këtë arsye, transhumanca duhet të integrohet në politikat kombëtare të zhvillimit rural, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe integritetit evropian si një prioritet strategjik dhe kurrsesi një praktikë e së kaluarës.

Rekomandimet:

- Për të mundësuar mbijetesën dhe rigjallërimin e transhumancës, është e nevojshme që Qeveria e Shqipërisë të krijojë një Program Kombëtar të Transhumancës, përmes integritetit të saj në politikat e zhvillimit rural, biodiversitetit, trashëgimisë kulturore dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimaterike.
- Për të mundësuar menaxhimin e qëndrueshëm të kullotave dhe ruajtjen e korridoreve tradicionale të shtegimit, është e nevojshme që institucionet kombëtare dhe vendore të investojnë në rehabilitimin e kullotave, shtigjeve, burimeve ujore dhe infrastrukturës mbështetëse, përmes fondeve të dedikuara dhe planeve afatgjata të menaxhimit.
- Për të mundësuar vazhdimësinë ekonomike të blegtorisë transhumante, është e nevojshme që MBZhR dhe AZhBR të krijojnë skema të posaçme mbështetjeje për barinjtë dhe fermat malore, përmes pagesave të diferencuara, mbështetjes për stanet, sigurimeve sociale dhe shërbimeve veterinare.
- Për të mundësuar që transhumanca të sjellë më shumë të ardhura dhe punësim në zonat rurale, është e nevojshme që institucionet publike, bashkitë dhe organizatat lokale të lidhin transhumancën me agroturizmin, produktet tradicionale dhe markat territoriale, përmes promovimit, certifikimit dhe zhvillimit të zinxhirëve lokalë të vlerës.

10

PRIORITETET KOMBËTARE
PËR VEPRIM
(2026-2030)

Në funksion të transformimit të zonave rurale dhe përshpejtimit të integritimit evropian të Shqipërisë, Parlamenti IV Rural Shqiptar u bën thirrje institucioneve kombëtare dhe vendore që të trajtojnë këto prioritete strategjike për periudhën 2026-2030:

1. Zbatimi i qasjes LEADER/CLLD në nivel kombëtar. Krijimi dhe financimi i GVV në të gjithë territorin rural të Shqipërisë si instrumenti kryesor për zhvillimin territorial me pjesëmarrje të komuniteteve lokale.
2. Hartimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar për Bujqësinë Familjare. Miratimi i një kuadri politik dhe financiar të dedikuar për forcimin e fermave familjare, në përputhje me Dekadën e OKB-së për Bujqësinë Familjare (2019-2028) si dhe Planin Kombëtar të Veprimit.
3. Program kombëtar për fuqizimin e grave në sektorin agroushqimor. Rritja e aksesit të grave në pronësi, financë, sipërmarrje, tregje, trajnime dhe vendimmarrje përmes masave të dedikuara dhe objektivave konkretë.
4. Program Kombëtar për AKIS dhe transformimin digjital të bujqësisë. Reformimi i shërbimeve të ekstensionit dhe transferimit të njohurive dhe inovacionit sipas modelit evropian A(R)KIS si dhe zhvillimi i "Portalit të fermerit" si platformë e integruar për informacion, aplikime, këshillim dhe shërbime publike.
5. Program kombëtar për tranzicionin e gjelbër dhe reziliencën klimatike. Investime madhore në ujitje, menaxhimin e tokës, mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore, përdorimin e qëndrueshëm të inputeve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
6. Formalizimi i tokës bujqësore dhe konsolidimi i fermave. Përshpejtimi i regjistrimit të tokës, adresimi i fragmentimit të fermave dhe krijimi i kushteve për investime, bashkëpunim dhe rritje të konkurrueshmërisë.
7. Zhvillimi i zinxhirëve të shkurtër të vlerës dhe tregjeve lokale. Mbështetje për organizimin e fermerëve, tregjet lokale, produktet tradicionale, përpunimin në fermë dhe lidhjen direkte prodhues-konsumator.
8. Program kombëtar për të rinjtë në zonat rurale. Krijimi i instrumenteve të posaçme për punësimin, sipërmarrjen, inovacionin dhe rikthimin e të rinjve në ekonominë rurale.
9. Program kombëtar për mbrojtjen dhe zhvillimin e transhumancës. Njohja e transhumancës si aset strategjik kombëtar për biodiversitetin, ekonominë malore, turizmin rural dhe trashëgiminë kulturore, përmes një plani të dedikuar.
10. Partneritet kombëtar për zhvillimin rural. Krijimi i një mekanizmi të përhershëm dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike, autoriteteve vendore, organizatave të fermerëve, shoqërisë civile, akademisë dhe sektorit privat për zbatimin dhe monitorimin e prioriteteve të zhvillimit rural.

Parlamenti IV Rural Shqiptar riafirmon se zhvillimi rural duhet të mbetet prioritet kombëtar dhe një komponent i rëndësishëm i procesit të integritit evropian të Shqipërisë. Zbatimi i rekomandimeve dhe prioriteteve të kësaj Deklarate kërkon angazhim të vazhdueshëm politik, koordinim ndërinstytucional dhe partneritet të gjerë ndërmjet institucioneve publike, autoriteteve vendore, organizatave të fermerëve, shoqërisë civile, akademisë, sektorit privat dhe partnerëve të zhvillimit. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe partnerët e Parlamentit Rural Shqiptar do të vijojnë të mbajnë gjallë dialogun politik, të monitorojnë progresin në adresimin e këtyre prioriteteve dhe të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi nxitës për një Shqipëri rurale më konkurruese, më gjithëpërfshirëse dhe më të qëndrueshme në rrugën e saj drejt BE-së.